


RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E KLINËS- 2025





RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E KLINËS- 2025

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci Nr.67, Prizren,
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7

www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org

049 714 024

Qershor, 2026

Përmbajtja:

HYRJE.....	4
GJETJET E RAPORTIT.....	5
Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor.....	5
Korniza ligjore.....	6
Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit.....	6
Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor.....	7
Menaxhimi i mbeturinave.....	8
Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave.....	9
Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike.....	11
Licencimi dhe lejet mjedisore.....	12
PËRFUNDIME.....	13
REKOMANDIMET.....	15
Për EC:.....	16

HYRJE

Metodologjia për monitorimin mjedisor në nivel komunal është hartuar si instrument profesional për vlerësimin sistematik të gjendjes së mjedisit dhe funksionimit të mekanizmave institucionale në komunat e Kosovës. Dokumenti synon të krijojë një kornizë të standardizuar për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave mjedisore, duke siguruar krahasueshmëri dhe koherencë ndërmjet komunave.

Kjo metodologji mbështetet në të dhëna primare të siguruar përmes pyetësorëve të strukturuar të plotësuar nga institucionet komunale përgjegjëse për çështjet mjedisore për periudhën janar - dhjetor 2025, si dhe në të dhëna sekondare të nxjerra nga raporte zyrtare komunale, dokumente institucionale dhe burime të tjera relevante që kontribuojnë në plotësimin dhe verifikimin e analizës.

Metodologjia e ndjekur nga EC Ma Ndryshe për përpilimin e këtij raporti merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, si:

Ligji nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit

Ligji nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës

Ligji nr.08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

Ligji nr.08/L-137 për pyjet e Kosovës

Ligji nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës

Ligji nr.04/L-060 për mbeturina dhe Ligji nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e tij

Ligji nr.06/L-035 për veprimtaritë hidrometeorologjike

Ligji nr.08/L-065 për produktet biocide

Ligji nr.02/L-53 për gjuetinë

Ligji nr.04/L-197 për kimikate

Ligji nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor

Ligji nr.04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit.

Metodologjia bazohet në analizën e këtyre komponentëve kryesorë të menaxhimit mjedisor:

- Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor
- Korniza ligjore
- Dokumentet e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor
- Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor
- Sistemet e monitorimit mjedisor
- Sistemet e menaxhimit të të dhënave mjedisore
- Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja publike
- Licencimi dhe lejet mjedisore

Në këtë kuadër, analiza synon të trajtojë në mënyrë të strukturuar elementet kryesore që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi dhe praktikrat institucionale në nivel komunal.

Gjetjet e paraqitura në këtë dokument identifikojnë çështjet kryesore dhe sfidat aktuale në sektorin e mjedisit, duke reflektuar gjendjen reale në bazë të të dhënave të ofruara nga institucionet komunale. Këto gjetje evidentojnë nevojën për përmirësim të kapaciteteve institucionale, si dhe për forcimin e proceseve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor.

Në funksion të kësaj analize, në pjesën përfundimtare janë paraqitur rekomandime konkrete, të cilat synojnë përmirësimin e praktikave ekzistuese dhe avancimin e menaxhimit mjedisor në nivel komunal, drejt një qasjeje më të qëndrueshme dhe efektive në mbrojtjen e mjedisit dhe resurseve natyrore.

GJETJET E RAPORTIT

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Klinës, përgjegjësitë për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor janë të organizuara në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Organi komunal	A është themeluar	Emri zyrtar	Fuqia aktuale punëtore
Drejtoria	Po	Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit	-
Sektori	Po	Sektori për Banim dhe Ndërtim	-
Zyrtarë mjedisor	Po	Zyrtare për mjedis	-
Sektori	Jo	-	-
Zyrtarë mjedisor	Po	Zyrtare për mjedis	-

Tabela 1. Skema institucionale lokale për menaxhimin mjedisor

Sa i përket kapaciteteve njerëzore, numri i angazhuar i shërbyesve civil vlerësohet i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore.

Po ashtu, shërbyesit civil posedojnë profilet e nevojshme profesionale për realizimin e detyrave në fushën e mjedisit.

Në aspektin e përgatitjes profesionale, niveli i përgatitjes së stafit është vlerësuar me notën maksimale (5/5).

Sa i përket organizimit të trajnimeve për kornizën ligjore, nuk janë organizuar trajnime gjatë viteve 2024 dhe 2025.

Ndërsa në fushën e çështjeve mjedisore janë organizuar trajnime nga organizata joqeveritare lidhur me ndotjen e tokave.

Komuna shfrytëzon udhëzues të zhvilluar nga niveli qendror për menaxhimin e çështjeve mjedisore, përfshirë Udhëzimin Administrativ MMPH Nr.01/2017.

Korniza ligjore

Komuna e Klinës, në ushtrimin e përgjegjësive për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor, mbështetet në legjislacionin përkatës në fuqi.

Ligjet kryesore të përdorura për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor përfshijnë:

- Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Ligjin për Menaxhimin e Mbeturinave.

Korniza ligjore mjedisore vlerësohet si e konsoliduar.

Sa i përket njohurive të stafit për kornizën ligjore, ato vlerësohen në nivel shumë të mirë, me notën maksimale (5/5).

Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

Komuna e Klinës ka hartuar dokumente të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga korniza ligjore.

Dokumentet kryesore të identifikuara përfshijnë:

- Plani Zhvillimor Komunal 2025-2033;
- Harta Zonale 2020-2028;
- Plani për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027 - Klinë;
- Draft Plani për Mjedis.

Sipas të dhënave të siguruara, strategjitë mjedisore lokale janë harmonizuar me strategjitë qendrore.

Sa i përket zhvillimit të projekteve mjedisore, komuna ka realizuar projekte për zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbëruara, ndërtimin e parqeve, ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza, ndërtimin e shtretërve të lumenjve, si dhe ndërtimin e ngrohjeve me pompa termike.

Po ashtu, në kuadër të masave për mbrojtjen e mjedisit janë realizuar aktivitete për zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbëruara, ndërtimin e parqeve, ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza, ndërtimin e shtretërve të lumenjve dhe mbjelljen e fidaneve.

Projektet dhe aktivitetet kryesore përfshijnë:

Nr.	Projekti / Investimi	Vlera (€)	Komponenti mjedisor
1	Ndërtimi i fundërruesit për sistemin e filtrimit të ujit të pijes në Klinë	849,921.63	Furnizimi dhe trajtimi i ujit
2	Ndërtimi i kanalizimit Shtupel-Kërrnicë-Binxhë-Grabç, faza 2	129,000.00	Kanalizim fekal
3	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbëruara (parqeve)	34,891.00	Hapësira të gjelbra
4	Ndërtimi i shtratit Lumëbardhi i Pejës Drenoc-Grabanicë	31,550.00	Menaxhimi lumenjve
5	Ndërtimi i shtratit të lumit Klina dhe rregullimi i Lumëbardhit të Pejës dhe Drinit të Bardhë	25,800.00	Menaxhimi i lumenjve

Tabela 2. Projektet kryesore mjedisore në Komunën e Klinës

Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore për mbrojtjen e mjedisit realizohet në nivel komunal.

Sa i përket raportimit të inspektimeve, Drejtoria e Inspektoriatit inspekton projektet për mjedis për zbatimin e kornizës ligjore.

Raportet e monitorimit të zbatimit të strategjive mjedisore përfshihen në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtorisë së Inspektoriatit.

Gjendja e deponive të mbeturinave monitorohet në mënyrë sistematike.

Sa i përket vlerësimit të ndikimit të deponive ekzistuese të mbeturinave në mjedis, KRM "Ambienti" raporton në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, me të cilën komuna ka marrëveshje.

Në aspektin e çrregullimeve mjedisore, janë identifikuar raste të deponive ilegale të mbeturinave.

Ndërsa raste të tejkalimit të eksploatimit të resurseve natyrore mbi kushtet e lejuara nuk janë identifikuar.

Ndërsa në Raportin e Kryetarit të Komunës theksohet se gjatë vitit 2025, në kuadër të aktiviteteve inspektive në fushën e bujqësisë dhe ambientit, janë realizuar gjithsej 54 kontrolle inspektuese, prej të cilave janë hartuar 43 procesverbale mbi konstatimin e gjendjes. Po ashtu janë shqiptuar 6 gjoba, përkatësisht 1 gjobë për shfrytëzim dhe bartje ilegale të zhavorrit, 4 gjoba për hedhje të mbeturinave në hapësira publike dhe 1 gjobë për djegie të mbeturinave dhe ndotje të ambientit. Sipas raportit, gjatë vitit 2025 janë inspektuar të gjitha objektet dhe veprimtaritë që posedojnë leje mjedisore komunale, ku numri i objekteve të pajisura me leje mjedisore komunale ka qenë 21. Gjithashtu, janë shqiptuar gjoba për mosposedim apo moszbatim të LMK-së, ndërsa nuk ka pasur fletëparaqitje në gjykatë. Realizimi i të hyrave për vitin 2025 ka qenë 627.20 €.¹

Menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Klinës paraqet një komponent të rëndësishëm të menaxhimit mjedisor në nivel lokal. Vlerësimi i gjendjes mbështetet në të dhënat e raportuara nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës për vitet 2023 dhe 2024.

Sipas të dhënave, në vitin 2023 numri i banorëve të shërbyer në Komunën e Klinës ka qenë 45,038, ndërsa në vitin 2024 ky numër është raportuar 34,831 banorë, duke reflektuar një rënie prej 10,207 banorësh.²

Sa i përket sasisë së mbeturinave, gjatë vitit 2023 janë grumbulluar gjithsej 7,738 ton mbeturina komunale, ndërsa në vitin 2024 kjo sasi ka qenë 6,431 ton, duke reflektuar një ulje prej 1,307 tonësh.³

¹ Po aty

² Raporti i AMMK për menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë, publikuar në vitin 2025, linku: <https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/ALB%20Raporti%20per%20gjendjen%20e%20mbeturinave%20ne%20Kosove%202023-2024.pdf>

³ Po aty

Në aspektin e gjenerimit të mbeturinave për banor, në vitin 2023 është raportuar 171.81 kg/banor/vit, ndërsa në vitin 2024 ky tregues ka arritur në 184.63 kg/banor/vit, që paraqet një rritje prej 12.82 kg/banor/vit.⁴

Treguesi	2023	2024	Ndryshimi
Numri i banorëve të shërbyer	45,038	34,831	-10,207
Sasia e mbeturinave (ton/vit)	7,738	6,431	-1,307
Sasia e mbeturinave (kg/vit)	7,738,000	6,431,000	-1,307,000
Gjenerimi i mbeturinave (kg/banor/vit)	171.81	184.63	+12.82
Gjenerimi i mbeturinave (kg/banor/ditë)	0.47	0.51	+0.04
Shkalla e mbulimit me shërbim (%)	100.0%	100.0%	0%

Tabela 3. Statistikat kryesore për menaxhimin e mbeturinave - Komuna e Klinës

Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2024 në Komunën e Klinës është shënuar ulje e sasisë së mbeturinave të grumbulluara krahasuar me vitin 2023.

Megjithatë, në të njëjtën periudhë evidentohet edhe rënie e numrit të banorëve të shërbyer, çka ndikon në rritjen e treguesit të gjenerimit të mbeturinave për banor.

Në këtë kontekst, ndryshimet në treguesit e gjenerimit të mbeturinave duhet të interpretohen me kujdes, pasi ato mund të lidhen edhe me metodologjinë e raportimit dhe evidentimit të të dhënave.

Në përgjithësi, të dhënat reflektojnë nevojën për vazhdimin e përmirësimit të sistemit të menaxhimit të mbeturinave dhe harmonizimin e raportimit të të dhënave mjedisore në nivel komunal.

Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave

Komuna e Klinës nuk ka sistem të monitorimit të cilësisë së ajrit.

Komuna nuk posedon stacione për monitorimin e cilësisë së ajrit, ndërsa të dhënat sigurohen nga Regjioni i Pejës.

⁴ Po aty

Sa i përket monitorimit të cilësisë së dheut, komuna nuk ka sistem të tillë, ndërsa monitorimi realizohet vetëm në regjionin e Pejës.

Komuna e Klinës nuk ka sistem të monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Sa i përket monitorimit të cilësisë së ujit, KRU "Hidrodrini" realizon raportime mujore dhe vjetore.

Parashikimi dhe paralajmërimi i hershëm i vërshimeve dhe thatësirave nuk realizohet.

Sa i përket sistemit të menaxhimit të të dhënave mjedisore, departamenti ka ndërtuar sistem për menaxhimin e të dhënave mjedisore.

Po ashtu, departamenti posedon kapacitetet e nevojshme teknike dhe njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore.

Bashkëpunim, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Bashkëpunimi dhe koordinimi me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore vlerësohet në nivel të mirë (4/5).

Si shembull i bashkëpunimit me nivelin qendror përmendet hartimi i planeve strategjike mjedisore.

Po ashtu, bashkëpunimi dhe koordinimi me nivelin qendror në hartimin e strategjive mjedisore vlerësohet në nivel të mirë (4/5).

Në këtë aspekt janë përmendur planet strategjike mjedisore.

Bashkëpunimi dhe koordinimi me organizatat joqeveritare në hartimin e strategjive mjedisore vlerësohet gjithashtu në nivel të mirë (4/5).

Komuna ka zhvilluar procese me pjesëmarrje publike gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor.

Proceset e pjesëmarrjes publike janë zhvilluar për Planin Zhvillimor Komunal (PZHK), Draft Planin për Mjedis dhe Planin për Menaxhimin e Mbeturinave.

Sa i përket pjesëmarrjes publike në procese të tilla, ajo vlerësohet në nivel mesatar (3/5).

Licencimi dhe lejet mjedisore

Në vitin 2025 janë lëshuar 21 Leje Mjedisore Komunale për objekte dhe resurse që duhet të posedojnë Leje Mjedisore Komunale.

PËRFUNDIMET

Nga analiza e gjetjeve rezulton se Komuna e Klinës posedon strukturë institucionale funksionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Shërbyesit civil vlerësohen të mjaftueshëm për realizimin e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore dhe posedojnë përgatitje të mirë profesionale në fushën e mjedisit.

Korniza ligjore mbi të cilën mbështetet komuna vlerësohet e konsoliduar dhe menaxhimi mjedisor realizohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

Në aspektin e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor, komuna ka hartuar dokumente të rëndësishme strategjike, si Plani Zhvillimor Komunal 2025-2033, Harta Zonale 2020-2028, Plani për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027 dhe Draft Plani për Mjedis. Po ashtu janë realizuar projekte për zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbëruara, trajtimin e ujërave të zeza dhe përmirësimin e infrastrukturës mjedisore.

Sa i përket mbikëqyrjes inspektive, realizohen aktivitete të rregullta të inspektimit dhe monitorimit të zbatimit të kornizës ligjore. Gjatë vitit 2025 janë realizuar 54 kontrole inspektuese dhe janë shqiptuar gjopa për shkelje që lidhen me ndotjen e mjedisit dhe shfrytëzimin ilegal të resurseve natyrore.

Në fushën e menaxhimit të mbeturinave evidentohet ulje e sasisë së mbeturinave të grumbulluara gjatë vitit 2024 krahasuar me vitin 2023, megjithëse është evidentuar edhe rënie e numrit të banorëve të shërbyer. Gjenerimi i mbeturinave për banor ka shënuar rritje të lehtë ndërmjet dy viteve raportuese.

Komuna nuk posedon sistem funksional të monitorimit të cilësisë së ajrit, dheut dhe ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndërsa të dhënat sigurohen kryesisht nga institucionet rajonale dhe operatorët përkatës. Megjithatë, komuna posedon sistem dhe kapacitete për menaxhimin e të dhënave mjedisore.

Bashkëpunimi me nivelin qendror dhe organizatat joqeveritare vlerësohet në nivel të mirë, ndërsa pjesëmarrja publike në proceset e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor vlerësohet mesatare.

REKOMANDIMET

- 1.** Të vazhdohet forcimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale në fushën e menaxhimit mjedisor, përmes organizimit të trajnimeve dhe avancimit të stafit profesional.
- 2.** Të vazhdohet zbatimi dhe përditësimi i dokumenteve strategjike mjedisore dhe të sigurohet harmonizimi i tyre me strategjitë e nivelit qendror.
- 3.** Të forcohet sistemi i menaxhimit të mbeturinave dhe të vazhdojnë investimet në infrastrukturën mjedisore, përfshirë zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbëruara dhe trajtimin e ujërave të zeza.
- 4.** Të vazhdohet monitorimi dhe largimi i deponive ilegale të mbeturinave, si dhe të intensifikohen masat inspektive ndaj ndotësve të mjedisit.
- 5.** Të zhvillohet sistem funksional për monitorimin e cilësisë së ajrit, dheut dhe ujërave, me qëllim sigurimin e të dhënave më të sakta për gjendjen mjedisore në komunë.
- 6.** Të vazhdohet bashkëpunimi me institucionet qendrore, operatorët rajonalë dhe organizatat joqeveritare në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të të dhënave mjedisore.
- 7.** Të rritet niveli i pjesëmarrjes publike në proceset e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor përmes konsultimeve dhe aktiviteteve informuese me qytetarët.

Për EC:

EC Ma Ndryshe është organizatë me bazë në komunitet, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm me qasje gjithëpërfshirëse. Aktivizmi i EC-it synon një Kosovë ku qeverisja demokratike është pjesëmarrëse, transparente dhe llogaridhënëse, duke siguruar që institucionet, komunitetet dhe palët e interesit të punojnë së bashku drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Ky vizion promovon vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, politika më të fuqishme dhe përfshirje më të madhe të publikut, duke siguruar që qëndrueshmëria të jetë pjesë përbërëse e qeverisjes si në nivel lokal, ashtu edhe në atë kombëtar. Përmes koordinimit më të mirë institucional, hartimit të politikave të bazuara në dëshmi dhe angazhimit qytetar, angazhimi i EC-it synon të kapërcejë hendekun mes komuniteteve dhe institucioneve, duke siguruar që qeverisja e mirë të sjellë ndryshime të prekshme dhe afatgjata.

Deklarata e vizionit

“Fuqizimi i një Kosove elastike dhe gjithëpërfshirëse, ku komunitetet në mënyrë aktive formojnë institucione të qëndrueshme, të digjitalizuara dhe të ndërgjegjshme”.

Deklarata e misionit

“EC Ma Ndryshe përkrah qeverisjen demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socioekonomik, kulturor dhe të gjelbër përmes edukimit digjital, kujdestarisë mjedisore, mobilizimit të komuniteteve, avokimit për vendimmarrje publike me pjesëmarrje dhe kultivimit të partneriteteve strategjike”.

EC
MA NDRY SHE



www.ecmandryshe.org